



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, në përputhje me Elaboratin e Shpronësimit të “Rrugës Qarkore”, Planin Rregullues Urban “Dheu i Bardhë II/ 2013 “ si dhe me Rekomandimin e Komitetit për Pronë, Banim dhe Rindërtim të dt.29.05.2013, për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 27.06.2013, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private te vendi i quajtur “Gllama” Zona Kadastrale Gjilan

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private te vendi i quajtur “Gllama”, Zona Kadastrale Gjilan.**

II.

Lejohet këmbimi i pjesës së ngastrës kadastrale P-70403013-00034-0, lloji i njësisë – parcelë, lloji i pronës – private, me sipërfaqe prej 6733 m², vendi i quajtur “Gllama”, klasa e kualitetit – arë e klasës së IV-të, e cila evidentohet në emër të pronarit Limon (Qerim) Hasani nga Gjilani. Nga kjo parcelë këmbëhet sipërfaqja prej 908 m² të cilën e ka marrë Komuna dhe shfrytëzohet si rrugë publike e njohur si Rrugë Qarkore. Si kompenzim për këtë sipërfaqe tokësore, Komuna e Gjilanit i jep këtë pronari, sipërfaqen e njejtë prej 908 m², si pjesë e ngastrës kadastrale P-70403013-00001-3, lloji i njësisë – parcelë, me sipërfaqe prej 25390 m², e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjilan dhe gjendet në kufij me pronën private e cila është objekt i këtij këmbimi.

III.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të bënë parcelimin e ngastrave të cilat janë objekt i këmbimit dhe ta bënë regjistrimin e pronave të këmbyerë në regjistrat kadastral kurse prona private nr.34-0 të shlyhet nga **Elaborati i Shpronësimit “Rruga Qarkore” si rast i kryer.**

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VI.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës.

Nr.01_16-59040
Gjilan, më 27.06.2013

Kuvendi i Komunë
Izmi ZEKA, Kryesues